



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II nr.1285/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit “Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.”, me seli në Prishtinë, rr. “Robert Doll” nr.99, ndaj debitorëve 1. “Oltand Group” SH.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit 810110007 me adresë në rr. “Brigada 123” Suharekë, përfaqësuar nga A. B., dhe A. K., 2. A. B., me adresë në fshatin ..., Komuna e Suharekës, 3. A. K., me adresë në fshatin ..., Komuna e Suharekës, 4. “NNSH A&B Construction” me numër të regjistrimit të biznesit 71118835, përfaqësuar nga A. K., 5. “2A Partners” 1463/22 me numër unik identifikues 811508649 dhe 6. Sh. B., me adresë në fshatin ..., Komuna e Suharekës, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.68/24 të datës 20.05.2024, me datë 03.01.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa bazuar ankesa e kreditorit “Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.”, me seli në Prishtinë, rr. “Robert Doll” nr.99, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.68/24 i datës 20.05.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.68/24 të datës 20.05.2024, ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorëve Oltand Group” SH.P.K., A. K., dhe “NNSH A&B Construction”, i ushtruar kundër urdhrit përmbartimor P.nr.421/2023 të datës 08.12.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Mehdi Reshani, dhe i njejtë urdhër është shfuqizuar.

Kundër këtij aktvendimi, ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, dhe konstatimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë, ta prish aktvendimin e atakuar dhe lëndën t'ia kthej Përmbauesit Privat në procedim të sërishëm.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), pas vlerësimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, ka gjetur se:

- Ankesa e kreditorit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Përmbauesi Privat Mehdi Reshani, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.”, me seli në Prishtinë, ka lëshuar urdhrin për përmbaerim në bazë të Marrëveshjes mbi Linjën e Kredisë Nr.200718356 për shumën prej 30,000€, Marrëveshjes mbi lejimin dhe lëshimin e Visa Kredit kartelës dhe Shtojcën Nr.2. për ristrukturimin e marrëveshjeve të lartcekura si dhe Shtojcën Nr.2. të Marrëveshjes 200718356, si dhe Marrëveshjes Mbi Kredinë Nr.200722527 dhe Shtojcën për ristrukturimin e kësaj marrëveshje, duke detyruar debitorët që t'ia paguaj kreditorit borxhin në shumën e përgjithshme prej 29,075.39 Euro si dhe kamatën e rregullt dhe kamatëvonesën që do të arrij deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbaerimore të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, përmes bllokimit të gjitha llogarive në të gjitha bankat komerciale apo përmes sekuestrimit dhe shitjes së kolateralit.

Kundër këtij urdhri, debitori A. K., ka paraqitur prapësim duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin për lejimin e përmbaerimit, me arsyetimin se dokumenti në bazë të së cilit është marrë vendimi përmbaerues, nuk ka titull ekzekutiv apo nuk ka tiparet e përmbaerueshmërisë, andaj gjykatës i ka propozuar që Urdhri Përmbaerimor P.nr. 421/2023 i datës 08.12.2023, të anulohet dhe prapësimi i debitorit të aprovohet në tërësi si i bazuar.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit si të pabazuara, pasi që të njëjtat nuk janë mbështetur me asnjë provë të vetme duke e cilësuar kështu prapësimin në kundërshtim me dispozita ligjore të LPP-së. Tutje, ka theksuar se propozimi për përmbaerim i plotëson të gjitha kushtet ligjore pasi që i njëjti është iniciuar në bazë të dokumentit përmbaerimor dhe në të janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara me këtë ligj. Gjykatës i ka propozuar që të refuzoj në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe të lë në fuqi urdhrin përmbaerimor.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të prapësimit si edhe shkresave në lëndë, ka nxjerr aktvendimin KPPP.nr.68/24 të datës 20.05.2024, dhe ka pranuar prapësimin e debitorit i ushtruar kundër urdhrit përbarimor P.nr.421/2023 të datës 08.12.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Mehdi Reshani, dhe i njëjti urdhër është shfuqizuar.

Në arsyetimin e aktvendimit, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se dokumentet në bazë të së cilave është iniciuar procedura përbarimore, Marrëveshja mbi Linjën e Kredisë Nr.200718356, Marrëveshja mbi lejimin dhe lëshimin e Visa Kredit kartelës dhe Shtojca Nr. 2 për ristrukturimin e marrëveshjeve të lartcekura si dhe Shtojca Nr.2. e Marrëveshjes 200718356, si dhe Marrëveshja Mbi Kredinë Nr.200722527 dhe Shtojca për ristrukturimin e kësaj marrëveshje, nuk i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të përbarueshme në përputhje me nenin 22 të LPP-së, pasi që të njëjtat janë paraqitur në kopje, mbi të cilat kopje është vendosur vula e kreditorit.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka marr aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, i njëjti është i kuptueshëm dhe i qartë, prandaj vendimin e gjykatës, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë faktin se baza juridike për caktimin e përbarimit, dhe kushtet ligjore që duhet të plotësohen për të caktuar përbarimin sipas dokumentit të përbarimit, parashihen me nenin 38 par. 1 të LPP-së.

Sipas nenit 27 paragrafi 1 të LPP-së, është përcaktuar se *“Dokumenti përbarimor është i përshatshëm për përbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*. Tutje, sipas nenit 38 paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, përcaktohet se *“Propozimi për përbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përbarimi, kërkuesi i përbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit,*

kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit. 2. Në rast se propozimi për përmbarim nga paragrafin 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore”.

Edhe Dhomat e shkallës së dytë, pas analizimit të shkresave të lëndës vërejtë se dokumenti përkatësisht Marrëveshja mbi Linjën e Kredisë Nr.200718356, Marrëveshja mbi lejimin dhe lëshimin e Visa Kredit kartelës dhe Shtojca Nr. 2 për ristrukturimin e marrëveshjeve të lartcekura si dhe Shtojca Nr.2. e Marrëveshjes 200718356, si dhe Marrëveshja Mbi Kredinë Nr.200722527 dhe Shtojca për ristrukturimin e kësaj marrëveshje, në bazë të së cilave është iniciuar procedura përmbarimore, nuk janë në origjinal apo kopje të vërtetuar dhe rrjedhimisht të njëjtat nuk mund të konsiderohen si dokumente të përmbarueshme në kuptim të dispozitës së lartcekur, andaj për këtë arsye vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e shkallës së dytë ka evidentuar se kreditori me ankesë ka paraqitur prova të reja, ashtuqë i njëjti ka bashkangjitur në kopje të noterizuar dokumentet në bazë të së cilave është iniciuar procedura përmbarimore, mirëpo kjo gjykatë nga shkresat e lëndës gjen se kreditori ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 180 par.1 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Në ankesë nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të propozohen prova të reja, përveç se kur ankuesi jep prova se pa fajin e vet nuk ka mundur t’i paraqesë, përkatësisht t’i propozojë gjer në përfundimin e shqyrtimit kryesor në gjykatën e shkallës së parë”*, kjo pasi kreditori nuk i ka parashtruar këto prova në procedurën e zhvilluar në shkallë të parë, mirëpo këto prova i ka parashtruar vetëm në gjykatën e shkallës së dytë dhe nuk ka dhënë prova se pa fajin e vet nuk ka mundur t’i paraqesë, përkatësisht t’i propozojë deri në përfundimin e procedurës në gjykatën e shkallës së parë.

Dispozita ligjore që parashikon se në ankesë nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe prova të reja, përveçse në raste të veçanta kur ankuesi tregon se nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose prova pa fajin e tij, ka si qëllim sigurimin e drejtësisë dhe efikasitetit të procesit gjyqësor. Prandaj, për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm dhe të rregullt të gjendjes faktike, gjykata e shkallës së parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe gjykata e shkallës së dytë.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.1285/24 me datë 03.01.2025

Gjyqtari

Krenar Berisha